



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:226412
Datë: 21.11.2024
Numri i dokumentit: 06487473

P.nr.713/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM/ Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor Dardan Tolaj, në çështjen penale kundër të pandehurit Burim Krasniqi nga P, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer vepër penale „Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.1 nënpar. 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.469/2023 të dt.09.08.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 05.11.2024, në praninë e Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit Burim Krasniqi me datë 06.11.2024, shpalli, ndërsa me datë 21.11.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

BURIM KRASNIQI, i lindur me datë..... në P, nga e ëma F, me vendbanim në lagjen D .. në P., i pa punë, i martuar, ka të kryer gjashtë klasë të shkollës fillore, i gjendjes së dobët financiare, i identifikuar me numër personal, posedon numër telefoni, i nacionalitetit R..., shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, Më dt. rreth orës 19:00 min, në P. në rr. “B. B.” saktësisht afër furrës së bukës “A. 2”, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet, bashkëjetueses së tij- këtu të dëmtuarës - T. A., në atë mënyrë që derisa e dëmtuara ishte duke shkuar tek tezja e të pandehurit në lagjen “D.” për t’i treguar për maltretimin që po ia bene i pandehuri dhe për disa video që i kishte pranuar nga shoku i të pandehurit ku në të cilat sipas saj shihet i pandehuri duke konsumuar substanca narkotike, dhe kur arrin në vendin e lartcekur i pandehuri i del para dhe më qëllim që ta ndaloj të dëmtaren mos të shkoj tek tezja e tij, e sulmon fizikisht të njëjtën duke e goditur disa here më grushta në trup, me ç’rast i shkakton lëndime të lehta trupore, të përshkruara me hollësisht në Raportin e ekspertit mjeko-ligjor Dr. Flamur Blakaj të dt. 15.03.2023.

- me çka ka kryer vepër penale „Lëndim i lehtë trupor ” nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Andaj, konform nenit 7, 38, 39, 40, 43, 69, 70, nenit 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së dhe nenit 364, 365, 452 par.1, 462 par.2 të KPRK-së, gjykata të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- I.** shumën në lartësi prej **1200€ (njëmijë e dyqind euro)**
- II.** Të pandehurit i lejohet pagesa e gjobës në **3 këste mujore të barabarta, nga 400 (katërqind) euro**, ashtu që i njëjti detyrohet që të filloj pagesën menjëherë **muajin e parë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit**, duke filluar **nga data 1 deri me datën 5 të çdo muaji vijues, gjer në pagesën definitive.**
- III.** Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk paguan me kohë këstet e dënimit e shqiptuar me gjobë si në piken III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **kjo mundësi e pagesës me këste do të revokohet.**
- IV.** Nëse dënimin e shqiptuar me gjobë i akuzuari **nuk mundet apo nuk dëshiron që ta paguajë** gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, **do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ku një ditë me burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro të gjobës.**
- V.** I pandehuri obligohet të paguaj e shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej **20 € (njëzetë euro)**, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- VI.** I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej **20 € (njëzetë euro)**, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- VII.** Pala e dëmtuar T. A. me vendbanim në f.sh Z.komuna I., rr. "V. G.", për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjën, PP/II.nr.469/2023, të dt.09.08.2024, kundër të pandehurit, Burim Krasniqi nga Peja, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer vepër penale „Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPRK-së, gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 05.11.2024 në praninë e Prokurori i Shtetit, Ermal Demhasaj të pandehurit Burim Krasniqi, ndërsa ka munguar pala e dëmtuar T. A., pasi seanca është mbajt sipas urdhër arrestit.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës, gjykata e bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke i udhëzuar për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, konform dispozitës së nenit 241 par.4 të KPPRK-së.

I pandehuri Burim Krasniqi, deklaroi se e pranon në mënyrë vullnetare fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, pranimin e fajësisë e ka bërë pa asnjë presion dhe pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Prokurori i shtetit nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi është bërë në mënyrë vullnetare, me vetëdije të plotë, duke e kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe meqenëse ka mbështetje në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve të cilët u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, e ka miratuar pranimin e fajësisë pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e tij është bërë vullnetarisht konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë Akt-ekspertimi mjeko-ligjor i ekspertit Dr. F.B. i dt. 15.03.2023, Raporti i oficerit B. S. më nr. të rastit i dt. 02.03.2023, Raporti informues më nr. të rastit i dt. 03.03.2023 nga Stacioni Policor në Pejë, Deklaratat e të dëmtuarës T. A. e dhënë në polici më dt. 02.03.2023 dhe 03.03.2023, Deklarata e të pandehurit Burim Krasniqi dhënë në polici më dt. 02.03.2023, Deklarata e të miturit M. Z. dhënë në polici më dt. 03.03.2023, dy kopje të mesazheve të dërguara përmes telefonit si dhe shkresa tjera të lëndës.

Prokurori i shtetit lidhur me caktimin e dënimit i propozoi gjykatës, që në kontekst të rrethanave lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese dënimet eventuale të mëparshme.

I pandehuri i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit si rrethana lehtësuese për të merren parasysh pranimi i fajësisë, pendimi si dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra tjera penale.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Burim Krasniqi qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale „Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se tek të pandehurit ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjykata gjatë procedurës penale nuk gjeti rrethana të cilat do të zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata, për vendimin mbi dënim ka vendosur pasi që i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, ka vlerësuar faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë, është penduar për atë çfarë i ka shkaktuar viktimës, kërkim faljen publike ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori faktin se vepra është kryer brenda marrëdhënies familjare.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurit. Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja respektivisht përsëritja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në të cilat të pandehurit obligohen t'i paguajnë brenda afatit e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 462 par. 2 të KPPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën gjykata e udhëzoi në kontest juridiko civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM/Divizioni Penal
P.nr.713/2024, me datë 21.11.2024

Praktikanti Gjyqësor

Dardan Tolaj

Gjyqtare e vetme gjykuese

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.